



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 18, DATË 27.02.2020

PËR
RINOVIMIN E AUTORIZIMIT TË SHOQËRISË “TRING TV” SH.A., PËR
OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV, PËR PËRSËRITJEN E
SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË
RRJET SATELITOR

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, nenit 55, pika 4/a të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 14 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 587 prot., datë 10.02.2020, për rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tring Tv” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tring TV” sh.a., me NIPT: K61931005K dhe administratorë të shoqërisë: zj. Ridvana Dulaku, z. Artan Dulaku dhe z. Sotiraq Toshi, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Kushtet e autorizimit të shoqërisë “Tring TV” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor, mbeten të pandryshuara.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 19.07.2019.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA